

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R E

**Lindita NIKOLLA**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE  
PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2022**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive,

**Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2022 në këto drejtime:**

Angazhimin për rritjen e veprimtarisë në sektorin e edukimit shkollor me gjetjen e formave interaktive të përcjelljes së historisë së komunizmit, si dhe trajnimin e mësuesve për mënyrën e informimit mbi komunizmin.

Realizimin e konferencës ndërkombëtare “Arkitektura gjatë regjimit komunist në Shqipëri 1945-1990”, me qëllim njohjen e të rinjve dhe informimin e publikut të gjerë me aspekte ideologjike të arkitekturës në komunizëm.

Shpërndarjen e botimeve të ISKK-së në 38 biblioteka bashkish dhe universitetesh në të gjithë Shqipërinë.

Rinovimin e marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me qëllim rritjen e aksesit në sektorin e edukimit shkollor të informacionit për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.

Mbledhjen e dëshmime të të dënuarve për arsye politike, botimin e tyre dhe informimin e publikut për jetën në burgje, internim, dëbim dhe forma të tjera persekutimi.

**Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:**

1. Me deklasifikimin e dokumenteve të Sigurimit të Shtetit të fokusohet te kjo pjesë e historisë së komunizmit për të zbardhur mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Sigurimit të Shtetit.

2. Të intensifikojë bashkëpunimin me shoqatat vendase dhe të diasporës për mbledhjen e dëshmime që janë jashtë kufijve, si një burim potencial për zgjerimin e arkivës audio-vizuale apo kolanës së botimeve.

3. Të angazhohet për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të edukimit qytetar, duke nxitur reflektim dhe diskutim tek të rinjtë për krimet dhe pasojat e komunizmit në vendin tonë përmes përdorimit të formave inovative të informimit.

4. Të bashkëpunojë me Autoritetin për Informimin mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për pasurimin e databazës me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t'i bëjë të aksesueshme për qytetarët.

5. Në funksion të transparencës dhe informimit, të bëhet publike në faqen online e gjithë procedura e rekrutimit të Këshillit Shkencor dhe vendimmarrja e këtij Këshilli.

Miratuar në datën 8.6.2023